



DATA/DATUM/DATE	18.04.2024
01 NR/BR	83/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës Kryesudit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetari i Komunës Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim - Vendim për Themelimin e Forumit të Panelit për Transparencë Komunale për Kuvendin e Komunës së Ferizajt.

Në bazë të nenit 58, shkronja h të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/15 Qershor 2008), të nenit 51 paragrafi 2 pika 9 e Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, si dhe me kërkesë të NDI (Nacionale Democratic Institute) Kryetari i Komunës bënë:

### PROPOZIM - VENDIM

Për themelimin e Forumit të Panelit për Transparencë Komunale për Kuvendin e Komunës së Ferizajt.

### Arsyetim

Ky forum që do të themelohet ka për detyrë monitorimin e procedurave administrative që janë të lidhura drejtpërdrejt me nivelin e transparencës, të bëjë edhe hartimin e Planit të veprimit të tij nisur nga specifikat kryesore që diskutohen brenda grupit-ve të ndryshëm shoqëror si dhe këshillimin e akterëve Komunal për çështje të caktuara, të cilat duhet të bashkangjiten më pas në Raportin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt.

Ky forum fillimisht duhet të ketë nga një përfaqësues nga secili grup i subjekteve politike në Kuvend të Komunës, mirëpo mund të ndryshohet nga nevojat specifike të Komunës.